



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 1642/2000 REGJ.THEM
Vendimi

Nr. 1579

Datë 06.06.2022

-

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTAR : ALBERT MEÇA

asistuar nga sekretare gjyqësore Mimoza Noka, në séancë gjyqësore, sot me datë **06.06.2022**, shpall këtë vendim lidhur me çështjen penale që i përket :

AKUZUES : Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përfaqësuar nga prokuror Ylli Bashaj.

KUNDËR

I PANDEHUR : Ervis Domi, i biri Zylyfiut dhe Nazmijes, i datëlindjes 19.01.2000 , lindur dhe banues rruga “Alush Frakulla” Tiranë , me kombësi e shtetësi shqiptare, me arsim të mesëm, beqar, gjendja gjyqësore i padënuar më parë, hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi “Arrest në burg”, përfaqësuar nga av. Erjon Kullolli.

AKUZUAR : Për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 pg.1 kodit penal.

I PANDEHUR : Klajdi Maleçka, i biri Hekuranit dhe Behijes, i datëlindjes 11.07.2001, lindur dhe banues rruga “Aleksandër Moisiu” Tiranë , me kombësi e shtetësi shqiptare, me arsim të mesëm, beqar, gjendja gjyqësore i padënuar më parë, hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, në mungesë.

AKUZUAR : Për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 pg.1 kodit penal.

OBEKTI : 1. Gjykimin e të pandehurit Ervis Domi akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 pg.1 kodit penal.

2. Pushimin e akuzës për të pandehurin Klajdi Maleçka akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 pg.1 kodit penal

Në diskutimin përfundimtar palët kërkuar :

Prokuroria : Të deklarojë fajtor të pandehurin Ervis Domi për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij sipas ligjit. Pushimin e akuzës parashikuar nga neni 283 i Kodit penal për të pandehurin Klajdi Maleçka.

I pandehuri Ervis Domi deklaroi se është i penduar dhe kërkon një dënim sa më të lehtë.

Avokati i tij deklaroi se i pandehuri është i penduar dhe kërkoi pezullimin e dënimit sipas parashikimeve të nenit 59 të Kodit penal.

I pandehuri Klajdi Maleçka nuk u paraqit në seancën e fundit gjyqësore

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e palëve, shqyrtoi provat dhe çështjen në tërësi

VËREN

Se organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë i është drejtuar Gjykatës me një kërkesë, e cila përmban dy kërkesa, përkatësisht :

1. Dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. 6480 të vitit 2021 me të pandehur Ervis Domi, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje të narkotikës” dhe në bazë të nenit 283/1 të Kodit Penal.

2. Pushimit të hetimeve të akuzës së personin nën hetim Klajdi Malecka për veprën penale “Prodhimi dhe shitje e narkotikëve” parashikuar nga neni 283 pg.1 i Kodit penal.

Nga ana procedurale kërkesa e prokurorit për dërgimin në gjyq të çështjes penale dhe për pushimin e akuzës u shqyrtua në të njëjtën seancë gjyqësore në përputhje me nenin 329/a/2 të K.Pr.Penale që parashikon: *“Në rastet kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq”*.

I pandehuri Ervis Domi, asistuar edhe nga avokatja e tij, kërkoi të procedohet me gjykim të shkurtuar. Duke qenë në këto rrethana, Gjykata vlerëson se duhet zbatuar neni 332/dh germa c) i K.pr.penal, sipas të cilit : *“ Pasi dëgjon diskutimet e palëve, Gjykata vendos : ... c) të ftojë palët të paraqesin diskutimet përfundimtare kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t’u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë”*.

Duke i marrë në harmoni frymën dhe germën e dy dispozitave të mësipërme, Gjykata vlerëson se si kërkesa për gjykimin e të pandehurit Ervis Domi ashtu edhe kërkesa për pushimin e akuzës ndaj të pandehurit Klajdi Malecka duhet të shqyrtohen në të njëjtin procedim dhe Gjykata duhet të shprehet për të dy kërkesat e mësipërme.

Organi i prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur kërkesën për gjykimin e të pandehurit Ervis Domi duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale të mbajtjes dhe shitjes së lëndëve narkotike parashikuar nga neni 283 pg.1 i kodit penal, sipas së cilit :

“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në

kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.”

Meqenëse çështja mund të zgjidhej në gjendjen që ndodhen aktet, bazuar në nenin 332/dh dhe 405 të K.Pr.Penale, Gjykata vendosi të pranojë kërkesën e të pandehurit dhe të procedojë ndaj tij me gjykim të shkurtuar, qëndrim i cili është mbajtur edhe në Vendimin Unifikues nr 2 datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: *“Këtij gjykimi në dallim nga gjykimi i zakonshëm i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me pavlefshmërinë e tyre. Ligji parashikon që çështja zgjidhet në gjendjen që janë aktet, që nënkupton pranimin e tyre nga palët, ashtu sikurse janë. Gjykimi vazhdon me paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare, të cilat i referohen akteve të pranuar nga palët ashtu sikurse parashikon neni 405/5 dhe 6 i K.Pr.Penale dhe gjykata jep vendim bazuar në to.”*

Sipas kërkesës së prokurorisë rezulton se:

Mbasditen e dates 19.09.2021, rreth ores 15, nje patrulle e sherbimit policor te sektorit te Forces se Posagme “ Shqiponja strukture prane Drejtorise Vendore te Policise Tirane, e perbere Armeli Barjami, Klevis Jace dhe Arber Dingo, kur ka qene duke patrulluar ne rrugen “Njazi Meka” te qytetit te Tiranes, kane ndaluar autoveturen e markes NISSAN, me targe AA028GT. Ne bordin e autovetures kane qene shtetasit Klajdi Malecka, qe njeherazi ishte edhe drejtuesi mjeti dhe shtetasi Ervis Domi, pasagjer ne ndenjese e pare te mjetit. Ne kushtet e flagrances eshte kontrolluar brenda kabines se autovetures dhe ne dysHEME, mbrapa ndenjeses se pare te pasagjerit, eshte gjetur nje kuti kartoni, brenda te ciles ndodheshin kater pjese te bime, te ngjashme me ate narkotike te llojit “Cannabis Sattiva “, si dhe disa boce e te ketij materiali bimor, sasi e cila, eshte sekuestruar me cilesine e proves material. Pas peshimit, ka rezultuar ishin me peshe 35,0 gram. Pas konstatimit te ketyre fakteve, shtetasit Klajdi Malecka dhe Ervis Domi, te konsideruar si persona nen hetim, jane shoqeruar ne organin e policise dhe jane arrestuar ne kushtet e flagrances.

Te dhenat e mesiperme jane pasqyruar ne procesverbalet e kapjes ne fragrance te shtetasve Klajdi Malecka dhe Ervis Domi, te pershkrimet e peshimit te proves materiale lendes se dyshuar si narkotike, te sekuestrimit te sendeve prove materiale, raportit te sherbimi i perpiluar nga punonjesis e policise Armeli Barjami, Klevis Jace dhe Arber Dingo etj, akte te perpiluar ne daten 13.08.2021.

Nepermjet te dhenave te pasqyruara ne konkluzionet e aktit te ekspertimit, per materialet ne ngarkim te shtetasve Ervis Domi dhe Klajdi Malecka me Nr 12585 te dates 17.12.2021, mesohet se, materialet bimore objekt ekspertimi jane Cannabis, produkt herbal te bimes Cannabis Sattiva L dhe pesha e tyre, pa ambalazh eshte 33,00 gram. Dhe ne konkluzionet e aktit te ekspertimit me Nr 11917 te dates 22.11.2021, mesohet se pjeset e bimeve objekt ekspertimi jane pjese te bimes Cannabis Sattiva L.

Nga konkluzionet e aktit te ekspertimit toksikologjiko - ligjor te urines se shtetasit Ervis Domi, me Nr 2544 te dates 05.10.2021, mesohet se, ne urinen e tij, u zbulua prania e produkteve te kanabinoidike te metabolizmit te bimes Cannabis Sattiva L ne organizmin e njeriut.

Ndersa nga konkluzionet e aktit te ekspertimit toksikologjiko - ligjor te urines se shtetasit Klajdi Malecka, me Nr 2534 te dates 07.10.2021, mesohet se ne urinen e tij, u zbulua ne nivel gjurme prania e produkteve te kanabinoidike te metabolizmit te bimes Cannabis Sattiva L ne organizmin e njeriut.

I pyetur per faktet e mesiperme, i pandehuri Ervis Domi, pranon qe materiali bimor i gjetur ne autoveture, me te cilen ai udhetonte ishte blere prej tij dhe ai ka udhetuar me personin ne hetim Klajdi Malecka, pa e vene ne dijeni ate per materialin bimor.

Ndersa personi nen hetim Klajdi Maleçka, i pyetur per te njejtat fakte, sipas te dhenave te pasqyruara ne procesverbalin e dates 19.09.2021, deklaroi se nuk ka dijeni per bimen narkotike, te vendosur ne autoveturen qe drejtonte ai dhe bashkeudhetarin e ka gjetur ne rruge dhe ka udhetuar me te, deri ne momentin, qe jane ndaluar nga sherbimet e policise.

Faktet e cituara me sipër, por edhe te tjere, te grumbulluara gjate hetimevece paraprake tregojne se, pavarsisht dyshimeve, te ngritura per bashkepunimin mes tyre te personave nen hetim ne fjale, dyshime te cilat nuk mbeshteten me prova dhe nuk e kapercejne kete kufi, nuk provojne se, personi nen hetim Klajdi Maleçka eshte bashkepunetor me te pandehurin Ervis Domi, ne kryerjen e vepres penale te sipercituar. Ky i fundit, eshte autori i vetem i vepres penale te “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve”, qe parashikohet nga neni 283/1 i K. Penal. Vertetohet se, ai eshte mbajtes i nje sasie te konsiderueshme substance narkotike, e cila eshte pjese e substancave te ndaluara te listes, bashkelidhur ligjit Nr 7975 te dates 26.07.1995, “Per bamat narkotike dhe lendet psikotrope”, perdorimi abuziv i te cilave, demton shendetin dhe krijon varesi te perdoruesit nga keto lende.

Por persa i perket personit nen hetim Klajdi Maleçka, per te cilin nuk vertetohet se, eshte bashkepunetor ne kryerjen e vepres penale te-sipercituar, hetimet ndaj tij, nuk duhet te vazhdojne e ato duhet te pushohet.

Vec sa më sipër, gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, prokurori ka saktësuar se për të pandehurin Klajdi Maleçka kërkon vetëm pushimin e akuzës së parashikuar nga neni 283 i kodit penal, pasi për faktin e dyshuar të drejtimit të automjetit nën ndikimin e lëndëve narkotike do të procedohet vecmas.

Faktet e përmendura më lart rezultuan të provuara me aktet e paraqitura nga organi i prokurorisë, të cilat për shkak të gjykimit me procedurë të shkurtuar marrin vlerën e provës në gjykim (qëndrim i cili është mbajtur edhe nga Gjykata e Lartë me vendimin unifikues nr 2 datë 29.01.2003). Konkretisht :

- Nga procesverbali i kontrollit datë 19.09.2021 dhe tabela fotografike përkatëse, ku janë përshkruar koha dhe vendi i kontrolluar, sendet e gjetura, përshkrimi i tyre, etj.
- Nga procesverbali i kapjes në flagrancë të të pandehurve datë 19.09.2021 rezulton e provuar koha dhe vendi i kapjes së të pandehurve, sendet e gjetura në momentin e ndalimit, etj.
- Nga procesverbali i përshkimit dhe peshimit të lëndës së sekuestruar dhe nga procesverbali i sekuestrimit të saj datë 19.09.2021 janë përshkruar hollësisht lënda e sekuestruar, pesha e detajuar e saj me dhe pa ambalazh, është përshkruar mënyra e ambalazhimit, etj.
- Nga akt ekspertimet toksikologjike rezulton se janë egzaminuar mosata të urinës së të dy të pandehurve dhe janë gjetur gjurmë të përdorimit të lëndës narkotike cannabis sativa.
- Nga akt ekspertimi kimik Nr 11917 te dates 22.11.2021ka rezultuar se : “Pjesët e bimëve janë pjesë bime cannabis sativa L”.

Vetë i pandehuri Ervis Domi, nuk e ka kundërshtuar akuzën duke pretenduar se është përdorues i lëndës narkotike dhe lënda e gjetur ishte e tij. I pandehuri është shprehur i penduar dhe bashkëpunues gjatë hetimeve paraprake. I njejtë qëndrim pohues është mbajtur në gjykim edhe nga avokati i të pandehurit, i cili deklaroi se i pandehuri është në moshë të re në gjendje të vështirë ekonomike dhe i padënuar më parë.

i. Sa më sipër Gjykata krijon bindjen se provat janë të plota, të harmonizuara dhe krijojnë bindjen se i pandehuri Ervis Domi ka kryer veprën penale të mbajtjes së lëndëve narkotike

parashikuar nga neni 283 pg.1 i kodit penal. I pandehuri me dashje ka mbajtur një sasi lënde të klasifikuar ligjërisht si narkotike pa qenë i pajisur me leje përkatëse apo për shkaqe të justifikuara.

I pandehuri me veprimet e tij të kundraligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme ka cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar kontrollin mbi lëndët narkotike dhe psikotrope si edhe rendin publik në përgjithësi. I pandehuri është në gjendje të kuptojë dhe kontrollojë veprimet e tij dhe pasojat që vijnë prej tyre, ka mbushur moshën 18 vjec dhe prandaj duhet të përgjigjet penalisht.

Në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit Gjykata mban parasysh rrezikshmërinë e veprës dhe të të pandehurit. Kështu :

- Vepra penale e prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike po haset vazhdimisht dhe është një nga problemet shqetësuese i realitetit shoqëror shqiptar,
- I pandehuri është në moshë të re,
- Sasinë dhe llojin e lëndës narkotike të gjetur të pandehurit,
- Rrethanat e gjetjes së saj,
- Faktin se i pandehuri është përdorues i lëndëve narkotike
- Mënyrën e jetesës së të pandehurit si edhe
- Qëndrimin pohues dhe pendues të të pandehurit.

Duke i marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e mësipërme, Gjykata vlerëson se i pandehuri Ervis Domi duhet të dënohet me burgim se lloji i vetëm i dënimit të parashikuar nga neni 283 pg.1 i kodit penal.

Nisur nga disa rrethana lehtësuese si pohimi dhe pendimi i të pandehurit që në momentet e kontrollit e në vijim, lloji dhe sasia e lëndës së mbajtur, rrethanat e mbajtjes së saj, mënyra e jetesës së të pandehurit (sipas akteve të Bashkisë Tiranë ai është djalë i rregullt), gjendja e tij familjare, moshën e re të të pandehurit dhe faktin se sipas akteve të Prokurorisë është i padënuar më parë, Gjykata krijon bindjen se qëllimi i dënimit penal mund të realizohet edhe me anë të dënimeve alternative sipas parashikimeve të nenit 59 dhe 60 të Kodit penal. Në dhënien e vendimit Gjykata mban parasysh në mënyrë të veçantë se i pandehuri është kapur në posedim të katër degëve apo boceve të bimës cannabis sativa, të papërpunuar dhe të pandarë në doza.

Në bindjen e brendshme të Gjykatës ndikon edhe fakti se tashmë i pandehuri ka kryer një pjesë të dënimit të tij me kohën e kaluar në paraburgim që nga data 19.09.2021.

Për shkak të gjykimit me procedurë të shkurtuar, i pandehuri përfiton edhe uljen e 1/3 së dënimit sipas parashikimeve të nenit 406 të K.pr.penale.

Meqenëse Gjykata vlerëson se duhet pezulluar pjesa e pavujtur e dënimit, në zbatim të parashikimeve të nenit 261 dhe 389 të k.pr.penale duhet të urdhërohet heqja e masës së sigurimit dhe lirimi i të pandehurit, pasi në nenet e mësipërme parashikohet se :

“Me vendimin e pafajësisë a të pushimit, gjykata urdhëron lirimin e të pandehurit të paraburgosur dhe deklaron heqjen e masave të tjera të sigurimit. Në të njëjtën mënyrë disponohet edhe kur vendoset pezullimi me kusht i vendimit”.

Lidhur me provat materiale, qarkullimi i lëndës narkotike është i ndaluar dhe në zbatim të nenit 190 të k.pr.penale duhet të urdhërohet asgjësimi i saj.

Gjykata konstatoi se nga ana e Prokurorisë nuk është paraqitur kërkesë për llojin dhe masën e dënimit, duke kërkuar që i pandehuri të deklarohet fajtor dhe të dënohet sipas parashikimeve të nenit për të cilin akuzohet. Qëndrimin e mësipërm, Gjykata nuk e vlerëson në

përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, frymën e tij dhe praktikën gjyqësore, por njëkohësisht nuk ka mekanizëm ta pengojë apo korrigjojë këtë sjellje të prokurorisë. Pavarësisht sa më sipër, mungesa e kërkesës së Prokurorisë për llojin dhe masën e dënimit nuk përbëjnë shkak që Gjykata të mos japë dënim për të pandehurin.

ii. Në lidhje me kërkesën për pushimin e akuzës për të pandehurin Klajdi Maleçka, Gjykata vëren se :

Neni 328 pg.1 germa b i K.Pr.Penale ka përcaktuar se:

“1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:

a) del qartë se fakti nuk ekziston;

b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;

c) viktima nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij;

ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet;

d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë;

dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai;

e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale;

ë) i pandehuri vdes;

f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj.;

I njëjti përcaktim duhet zbatuar edhe në çështjen objekt gjykimi, pasi neni 329/a pg.1 i K.Pr.Penale ka parashikuar se: *“1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes.”*

Në çështjen objekt gjykimi, roli i Gjykatës është përcaktuar nga neni 329/b pg.3 i K.Pr.Penale, sipas të cilit: *“3. Kur janë kushtet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, gjykata vendos pushimin e akuzës ose çështjes....”*

Nga aktet e paraqitura në gjykim rezultojnë se procedimi penal me akuzë të parashikuar nga neni 283 i kodit penal për të pandehurin Klajdi Maleçka ka filluar mbi bazën e dyshimit pasi në makinën e drejtuar prej tij është një kuti me 4 boce (pjesë bime) cannabis sativa. Siç u argumentua më lart, lëndë narkotike i përkiste bashkë të pandehurit Ervis Domi dhe nuk ka asnjë provë që të provojë bashkëpunimin midis të pandehurve. Që në momentet e ndalimit ka qenë i pandehuri Ervis Domi që ka pranuar se lëndë është e tij dhe se i pandehuri Klajdi Maleçka nuk kishte dijeni për të.

Edhe nga kqyrja e telefonave të të pandehurve nuk ka rezultuar të ketë patur biseda implikuese midis tyre.

Nga procesverbali i kapjes në flagrancë apo raporti përkatës i shërbimit të policisë nuk përfitohet ndonjë e dhënë për të provuar se i pandehuri Klajdi Maleçka kishte lidhje me lëndën narkotike apo të kishte dijeni për egzistencën e saj.

Sa më sipër kërkesa e prokurorit për pushimin e akuzës “Prodhimi dhe shitje e lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 pg.1 i Kodit Penal në ngarkim të të pandehurit Klajdi Maleçka.

Në lidhje me dyshimin se i pandehuri Klajdi Maleçka mund të ketë kryer veprën penale “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i kodit penal, prokurori sqaroi se do të shprehet në një procedim tjetër. Duke qenë kështu, Gjykata duhet të vendosë

pushimin e akuzës vetëm në lidhje me faktin penal të gjetjes së boceve të canabisit në makinën e të pandehurit Klajdi Maleçka.

Për këto arsye, Gjykata krijoi bindjen dhe bazuar në nenin 329/b, 390 dhe 379 të K.Pr.Penale

VENDOSI

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ervis Domi (i biri Zylfiut dhe Nazmijes, i datëlindjes 19.01.2000) për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 pg.1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim.

Në zbatim të nenit 406 të K.pr.penale ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri Ervis Domi dënohet me 3 (tre) vjet 4 muaj burgim.

Bazuar në nenin 59 dhe 60 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të pjesës së pavuajtur të këtij dënimi, me kusht që i pandehuri Ervis Domi për një periudhë prove prej 4 (katër) vjet të mos kryejë veprë tjetër penale, të mos konsumojë lëndë narkotike, të mos shoqërohet me persona të dënuar si edhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës.

Në zbatim të nenit 261 dhe 389 të k.pr.penale masa e sigurimit “arrest në burg” në ngarkim të të pandehurit Ervis Domi caktuar nga Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 1644 rregj them, datë 22.09.2021, deklarohet e hequr dhe urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit Ervis Domi (i biri Zylfiut dhe Nazmijes, i datëlindjes 19.01.2000) nga ambientet ku mbahet i ndaluar, nëse nuk mbahet i arrestuar, i ndaluar apo i dënuar për ndonjë shkak tjetër.

Bazuar në nenin 190 të k.pr.penale prova materiale 4 (katër) bimë lëndë narkotike cannabis sativa me peshë totale 35 (tridhjetë e pesë) gramë të asgjësohet, ndërsa provat e tjera t’i kthehen personave që u përkasin.

2. Pranimin e kërkesës së Prokurorit.

Pushimin e akuzës “Prodhimi dhe shitje e lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 pg.1 i Kodit Penal në ngarkim të të pandehurit Klajdi Maleçka.

Shpenzimet procedurale i ngarkohen solidarisht të pandehurve Ervis Domi dhe Klajdi Maleçka.

Në zbatim të nenit 261 dhe 389 të k.pr.penale masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” në ngarkim të të pandehurit Klajdi Maleçka caktuar nga Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 1644 rregj them, datë 22.09.2021 (ndryshuar me vendimin nr. 930 rregj them datë 13.10.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë), deklarohet e hequr.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim nga i pandehuri dhe/ose prokurori në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall me 06.06.2022.

SEKRETARE

GJYQTAR

Mimoza Noka

ALBERT MEÇA

Shpenzimet gjyqësore

Fletethirje nje cope 150(njeqind e pesedhjete) leke

Shpenzime hetimore 21000 leke